



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM
Nr. 536, datë 25.09.2024

PËR
HAPJEN E PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM PËR NJË
POZICION TË LIRË NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM TIRANË

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” me ndryshime, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

V E N D O S I:

1. Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për transferim të përkohshëm deri në një vit.
2. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtares z. {...}, aktualisht gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, i cili ftohet për të dhënë pëlqimin për transferimin e përkohshëm.
3. Afati për dhënien e pëlqimit të jetë brenda ditës.
4. Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR